



## Sintagmat me folje të pashtjelluara në gjuhën shqipe si fjali të nënrenditura (përjasje e paskajores gege me lidhoren sipas modelit gjenerativ)

Brikena Liko

Faculty of History and Philology, University of Tirana, Editor, Academy of Sciences of Albania, Tirana, Albania

### Abstract

Vlerën e fjalive të nënrenditura në sintaksën gjenerative e kanë edhe foljet e pashtjelluara, të cilave në gramatikën tradicionale shqiptare përgjithësisht nuk u është njohur kjo vlerë predikative, përveç disa rasteve të veçanta.

Në këtë artikull do të trajtohen ndërtimet me folje të pashtjelluara të shqipes sipas këndvështrimit gjenerativ, për të parë nëse ato projektojnë një sintagmë të veçantë, cili element shërben si kokë e këtij ndërtimi e çështje të tjera lidhur me këtë. Në shqipe paskajorja gege është mënjeluar duke u zëvendësuar me lidhoren. Mirëpo nëse të parat janë folje të pashtjelluara, të dytat janë të shtjelluara, sintagma eptimore të cilave u është njohur edhe vlera predikative. Ndaj në fund të kësaj trajtuese do të bëhet një përjasje strukturore dhe kuptimore midis këtyre dy ndërtimeve që janë përdorur në vend të njëri-tjetrit.

Metoda e përdorur është analiza dhe përshkrimi, ndërsa materialet e shfrytëzuara janë vjelë nga disa romane të letërsisë shqipe bashkëkohore dhe e traditës, por edhe nga publicistika.


**Keywords:** sintaksë, sintagma me folje të pashtjelluara, sintagma eptimore, paskajorja gege

### 1. Introduction


Për të parë më qartë çështjen e trajtuar këtu, duhet të nisim me vështrimin fillimisht të sintagmave me folje të shtjelluara. Në rastin e formave të shtjelluara është e qartë se kemi një kokë funksionale që tregon elementet e eptimit të foljes, si: kohën, vetën, numrin. "Pranimi i kategorive funksionale bazohet në faktin se tema e një fjalëforme sillet ndryshe nga elementet eptimore që i shtohen asaj. Tema foljore shërben si kokë që përcakton strukturën e sintagmës foljore, kurse elementet eptimore lidhen ose me gjithë fjalinë ose me kryefjalën" (Memushaj, 2008: 153). Gjithashtu, siç pohohet në të gjitha studimet e drejtimit gjenerativ, fjalitë janë projektion i një sintagme eptimore në pozicionin e specifikuesit të së cilës gjenerohet kryefjala e realizuar fonetikisht (që mund të jetë sintagmë komplementuese ose emërore), ose e përealizuar fonetikisht (*pro* e vogël).

1. *Dosja ishte plot.* (I. Kadare, Pallati...75)
2. *Maksi qeshi me zë.* (I. Kadare. Dosja...79)
3. *Kam hyrë nëpër brimën e bravës.* (R. Qosja, Vdekja...97)
4. *U ngrit në këmbë.* (P. Marko, Qyteti...103)
5. *Bedrija nuk fliste.*
6. *Mendonte.*
7. *U harrua fare lehona.*
8. *U harrua fare klithma e kalamanit.* (P. Marko, Qyteti...170,171)


Të gjitha frazat e mësipërme janë sintagma eptimore. Eptimi shërben si kokë e gjithë ndërtimit. Ato kanë skemën e përgjithshme:



Siç ilustron në skemë, e gjithë fjalia është projektion i kokës funksionale në të cilën ndodhen elementet e eptimit. Fillimisht folja e sintagmës foljore – në kokën e së cilës (F<sup>0</sup>) gjenerohet një folje pa elementet e eptimit – ngrihet në pozicionin Ept<sup>0</sup> ku merr elementet e eptimit, kohën, vetën, numrin ku edhe realizon përshtatjen me kryefjalën e vet, argumentin e jashtëm. Ky i fundit mund të jetë një sintagmë emërore kur është i realizuar fonetikisht (si te shembujt 1, 2, 5), ose mund të jetë një *pro* kur nuk është e realizuar fonetikisht (si te shembujt 3, 4, 6). Kjo kryefjalë është argument i jashtëm kur gjenerohet në pozicionin e specifikuesit të sintagmës eptimore në shembujt 1, 2 dhe 5, por gjenerohet si argument i brendshëm në shembujt me folje në formën joveprore 7 dhe 8. Rastet si shembujt 7 dhe 8, me folje në formën joveprore, do të shihen në një syth të veçantë.



Në kokën Ept<sup>0</sup> për shqipen si një gjuhë me eptim të zhvilluar, mund të jenë elementet treguese të eptimit të cilat janë analitike (foljet ndihmëse dhe ato modale) ose sintetike (elementet që tregojnë mënyrën, kohën, vetën, numrin). Analitiket janë foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, pjesëzat formante që tregojnë mënyrën ose modalitetin: *të* (lidhore), *u* (kohën dhe formën). Sintetiket janë: mbaresat vetore (-j, -n, -jmë etj.), ndërrimet fonetike: *a - e, o - e, s - t, a - e + s - t*, (për disa folje këto ndërrime të shoqëruara me mbaresat vetore) të cilat në skemat përkatëse i paraqesim me rishkrimin e plotë të formës së foljes shoqëruar me nënvizimin e formantit ose formanteve që ndryshojnë) (ASHSH, 2002:277). Në rastin e frazave me folje të shtjelluara, forma përfaqësuese e foljes, ajo pa elementet e eptimit, ngrihet nga pozicioni i kokës F<sup>0</sup> në pozicionin e kokës Ept<sup>0</sup>:



Lëvizja ndodh edhe për specifikuesin, sintagmën emërore, e cila lëviz nga pozicioni i specifikuesit të sintagmës foljore drejt pozicionit të specifikuesit të sintagmës eptimore ku edhe bën përshtatjen me kallëzuesin dhe ku i caktohet rasia emërore. E njëjta analizë mund të bëhet edhe për rastet e tjera. Në rastet e mosrealizimit fonetik të kryefjalës, në pozicionin e SpecSF dhe SpecSEpt ndodhet përemri *pro*, por edhe vetë elementet e eptimit të foljes që për shqipen tregojnë vetën dhe numrin e kësaj kryefjale të pashprehur, por të nënkuptuar. Për sintagmat foljore me një folje të shtjelluar është e qartë se e kanë vlerën e fjalive të nënrenditura, diskutimi lind vetëm për foljet e pashtjelluara.

**2. Probleme dhe qëndrime për predikativitetin e formave të pashtjelluara në gjuhën shqipe**

Nuk do të ndalemi në diskutimet për predikativitetin e foljeve të pashtjelluara në gjuhën shqipe, pasi është vënë në dukje dhe është trajtuar në artikuj, studime dhe punime të mëparshme.

Shihet me vend vetëm të thuhet se në sintaksat tona të traditës, nga 1922 (Xhuvani) – 1952 (Cipo), foljeve të pashtjelluara u jepej vlerë predikative, thënë ndryshe, ato merreshin si fjali. Mirëpo në sintaksën e 50 viteve të fundit foljet e pashtjelluara janë konsideruar, në më të shumtën e rasteve si gjymtyrë fjali, pa vlerë kallëzuesie. Në *Gramatikën e ASH<sup>së</sup>* (f. 489) vlera e ndërtimeve me format e pashtjelluara foljore është konsideruar si një çështje e diskutueshme dhe me zgjidhje jo të njëjta në sintaksë. Aty është pohuar edhe se në disa gjuhë këto forma merren si fjali të varura, siç është vepruar edhe në traditën e mëparshme gramatikore tonën, në të cilën ato janë quajtur "fjali të varura të pashtjelluara". Çështja nëse duhen marrë si fjali të nënrenditura apo si gjymtyrë, sërish mbetet e hapur, përveç rasteve kur kanë kryefjalë të veçantë të shprehur ([*Duke perënduar dielli*], *aty na u bashkuan edhe vajzat.*) ose kur janë mjaftësisht të zgjeruara e të zëvendësueshme me fjali të ndryshme të varura. Ndër veprat e artikujt që kanë trajtuar këtë çështje, mund të përmendim Sh. Demiraj (*Gramatika historike e gjuhës shqipe*, 1988); M. Çeliku (*Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, 2016.); N. Veselaj (*Paskajorja çështje e shqipes standarde*, 2000); B. Bokshi (*Pjesorja e shqipes*, 1998); T. Kelmendi (*Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore*, 2010) etj.

Po në sintaksën gjenerative? Që me fillimin e zbatimeve të teorive gjenerativiste, edhe për shqipen është shtruar çështja e foljeve të pashtjelluara dhe është trajtuar nga studiues të ndryshëm duke paraqitur nga njëra anë qëndrimin sipas të cilit format e pashtjelluara nuk kanë vlerë predikative, dhe në anën tjetër qëndrimin që u jep të gjitha foljeve të pashtjelluara vlerën e një fjali të nënrenditur me një kryefjalë PRO (përveç rasteve kur foljes së pashtjelluar i përgjigjet një kryefjalë e veçantë, e ndryshme nga ajo e fjalisë drejtuese).

**3. Foljet e pashtjelluara në sintaksën gjenerative**


Në sintaksën gjenerative foljet e pashtjelluara kanë vlerë predikative dhe kanë statusin e një fjali të nënrenditur (Dhima, 2013: 47). Ashtu si sintagmat komplementuese, edhe këto kanë si kokë një kategori funksionale të lidhur: elementet që tregojnë llojin e foljes së pashtjelluar [*duke* (përcjellore), *pa* (mohore), *- për të* (paskajore), *me* (paskajorja gege)]. Në këto ndërtime me folje të pashtjelluara kemi praninë e një kryefjalës PRO të madhe.

**A projektojnë foljet e pashtjelluara një lloj të veçantë sintagme?**

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje na ndihmon elementi që tregon llojin e formës së pashtjelluar, pjesëzat: *me, për të, duke, pa, me të, një të*). Rëndësia e kësaj pjesëze është e madhe, sepse forma bazë e formës së pashtjelluar, pjesorja, është e njëjtë (p.sh. *punuar*), dhe është pikërisht kjo pjesëz që përcakton llojin e formës së pashtjelluar (*për të punuar, duke punuar* etj.). Meqenëse atyre u mungojnë elementet e kohës, vetës, numrit, nuk mund të kenë si projeksion eptimin, pra nuk mund të jenë një sintagmë eptimore, por meqenëse nuk kanë as elemente të mënyrës, atëherë nuk mund të jenë as projeksione të një sintagme mënyrore. Atëherë shtrohet pyetja: A duhen konsideruar sintagmat me folje të pashtjelluar si sintagma foljore të thjeshta? Nëse kësaj pyetjeje do t'i jepej përgjigje pozitive, atëherë pjesëzave që tregojnë llojin e

formës së pashtjelluar në shqipe do të duhej t'u caktohej vendi i specifikuesit të kësaj sintagme, pasi në pozicionin e kokës do të ishte folja. Mirëpo në sintaksën gjenerative foljeve të pashtjelluara u njihet një kryefjalë PRO e madhe e cila mund të jetë e njëjtë me atë të fjalisë drejtuese ose jo.<sup>1</sup> Pra në këtë rast nuk do të kishte vend për pjesëzën që tregon llojin e formës së pashtjelluar. Pra, ndërtimet me folje të pashtjelluara nuk mund të konsiderohen thjesht sintagma foljore, sepse në një sintagmë foljore nuk ka vend për vendosjen e elementeve që tregojnë llojin e formës foljore. Marrim p.sh. një ndërtim me formë foljore të pashtjelluar:

*I shënoi në një fletë për të pyetur mbikëqyrësin...* (I. Kadare, Pallati...f. 78)



Elementet që tregojnë llojin e formës së pashtjelluar nuk gjejnë vend në pozicionet e kësaj sintagme foljore.

Çështjen e formave të tipit *pa+pjesore, duke+pjesore, me të+pjesore, një të +pjesore, për të + pjesore*, e ka trajtuar së fundmi Kananaj (2015: 172). Autorja thotë se këta përbërës duhen konsideruar si *folje* jo si *forma foljore*, sepse shtjellueshmëria (tipari *i shtjelluar – i pashtjelluar*) është një tipar nënkategorial, që do të thotë se vjen pas përcaktimit të kategorisë së cilës i përkasin përbërësit e marrë në shqyrtim. Autorja ka arritur në përfundimin se format e pashtjelluara foljore kanë strukturë argumenti, njësoj si format e shtjelluara foljore dhe se ato janë gjithmonë fjali të nënrenditura. Ndërsa mbi statusin e tyre, ajo pohon se fjalitë me folje të pashtjelluar nuk mund të jenë sintagma lidhëzore, pasi vendosja e lidhëzave do të rezultonte jogramatikore. Kananaj u njeh atyre statusin e sintagmave kohore, ndaj, sipas autores duhen analizuar njësoj si fjalitë me folje të shtjelluara.

Mirëpo dihet se në teorinë e drejtimit dhe të lidhjes, një folje ngrihet në pozicionin e Ept<sup>0</sup> për të marrë aty elementet e eptimit, ndërsa këto pjesëza nuk janë elemente që tregojnë eptimin dhe përdoren për të shënuar kohë të ndryshme veprimi, ngjarjeje: *Por nuk i rrihej pa mësuar diçka për lavdinë, që tashmë e kishte humbur.* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 54) - e pakryer / *...ato zgjaten me qindra metra dhe u shërbejnë trafikantëve për shumë vjet pa u diktuar* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 57) - e tashme / *Pastaj bënte ecejake me hapa të lehtë, ende pa u afruar te mobilja e qoshes.* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 58) e pakryer / *Tani mos më lodh me llafe, kam kaq kohë pa vënë gjumë në sy.* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 62) - e

tashme / *Unë nuk mund të bindem pa i parë dhe pa i prekur.* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 64) - e tashme / *prindërit e vajzës ia mbyllën derën pa e lejuar të kapërcente as pragun.* (Z. Çela, Apokalipsi...f. 67) e kryer e thjeshtë.


Pra, këto elemente që nuk tregojnë eptim, nuk mund të zënë vend në kokën e sintagmës eptimore. Gjithashtu, duhet shtuar se ka edhe raste kur në këto ndërtime shfaqet edhe forma joveprore e foljeve, pjesëza "u", si në shembullin më poshtë:

*Pas pak do të vij vetë për t'ju kërkuar ca shpjegime.* (I. Kadare, Pallati...f. 77)

Ndaj shfaqet e nevojshme që të dallohet edhe projekcioni i sintagmës eptimore mbi atë foljore edhe në rastin e formave të pashtjelluara.

Për të analizuar këto ndërtime të shqipes, F. Koleci (2011: 129-138 dhe 2013: 136-141) ka zbatuar analizën e strukturave me sintagmë komplementuese të zgjeruar të propozuar nga Rizzi (1995). Në këtë sistem një vend me rëndësi zë sintagma e shtjellimit (*Finitness Phrase, FinP*) e cila qëndron një pozicion më lart sintagmës eptimore. Pikërisht në këtë sintagmë vendosen elementet që u përmendën më sipër, të cilat tregojnë llojin e formës së pashtjelluar, por ajo përmban edhe elemente të tjera, si: pjesëza *të* e lidhore, që është formë e shtjelluar. Meqenëse për këtë sistem është theksuar se "është i pranishëm në një strukturë të caktuar vetëm nëse është i nevojshëm, pra, nëse ndonjë përbërës shfaq tipare *Topic* dhe *Focus*" (Koleci, 2013: 176), ky sistem do të përdoret për analizën e ndërtimeve me forma të pashtjelluara, sidomos për krahasimin që është qëllim i këtij sythi.

Duke përvetësuar këtë model, analizojmë shembujt e mëtejshëm sipas këtij modeli analize, veçse, për të respektuar zgjedhjen e bërë që në fillim për përdorimin e emërtimeve të sintagmave dhe shkurtimeve përgjegjëse në gjuhën shqipe, edhe për këtë model do të vazhdojmë në të njëjtën linjë me shpjegimet si në fundfaqe\*. Skema e përgjithshme e këtij sistemi, e përshtatur, do të kishte paraqitjen e mëposhtme:



Në këtë sistem, në forma bazë e foljes zë pozicionin F<sup>0</sup>, në Ept<sup>0</sup> janë tiparet e eptimit, në Mën<sup>0</sup> pjesëza *të* e lidhore, në Shtj<sup>0</sup> do të gjejnë vend elementet që shënojnë llojin e formës së pashtjelluar.\*


\* SF (sintagmë foljore), SMën (Sintagmë mënyre), SEpt (sintagmë eptimore), SShtj (Sintagmë shtjellimi), SKl (sintagmë klitike), SForcë (sintagma e forcës, e cila tregon llojin e frazës - kundrinore, kryefjalore, kallëzuesore, relative apo kushtore - sipas G. Turano, 2011, vep. e cit. f. 95 : *që, se, nëse*).

\* Për më tepër mbi shpjegimin e *sistemit forcë-shtjellim* të Rizzi<sup>-1</sup>, shih: Turano, Giuseppina. *Hyrje... f. 94-98, 128*, ndërsa për zbatimin e tij për

<sup>1</sup> Këto ndërtime i ka trajtuar gjerësisht Buxheli, 2007, 2011; Turano, 2011.


◆ Shembulli i parë që do të paraqesim skematikisht dhe për të cilin do të shpjegojmë lidhjet e përbërësve është i thjeshtë. Pozicioni-kokë i forcës, i mënyrës dhe i eptimit janë bosh, pasi asnjë nga këto elemente nuk janë pjesë e ndërtimit. Sintagma foljore e pashtjelluar ka si komplement një sintagmë emërore, që shërben si argument kundrinor.

...duke kujtuar fjalën e urtë (Zija Çela, Apokalipsi sipas Shën Tiranës)




◆ Ndërtimi i mëposhtëm që do të sjellim është pak më i ndërlikuar, pasi ka edhe folje të pashtjelluar, edhe formantin "u" të formës joveprore, i cili zë vend në kokën Ept⁰.

...priste për t'u arratisur në Itali... (Z. Çela, Las varrezas, f. 114)



◆ Rasti tjetër do të jetë një ndërtim me folje të pashtjelluar, por edhe me një element klitik. Sintagma klitike qëndron si hierarki mbi atë eptimore (shih: Koleci, 2011: 88), ndaj do të shtohet edhe një projeksim tjetër midis projeksonit të sintagmës eptimore dhe asaj të mënyrës. Vetë folja e pashtjelluar merr si argument një sintagmë komplementuese (SK) me funksionin e kundrinorit.

...duke të detyruar të kërkosh hijen që i lë të qetë nervat e tua të ndjeshme për së tepërmi... (R. Qosja, Vdekja më vjen prej syve të tillë, f. 164)



Pra, pamë strukturën e sintagmave foljore të pashtjelluara (ose sintagmave me folje të pashtjelluar), të cilat kanë në çdo rast statusin e fjalive të nënrenditura, kanë një kryefjalë PRO edhe atëherë kur nuk e shprehur dhe këto ndërtime mund të gërshetohen me elemente të tjera të mënyrës, formës joveprore, klitikëve etj. Duke përdorur këtë model analize dhe paraqitjeje, në sythin pasardhës do të krahasohen ndërtimet me paskajoren gege dhe lidhoret përkatëse që përdoren për të zëvendësuar këto folje të pashtjelluara.

#### 4. Përfaqje e paskajores gege me lidhoren sipas modelit gjenerativ

Në kundërvënien paskajore gege – paskajore toske (*me punu / për të punuar*), është vënë në dukje se ato nuk janë gjithmonë të barasvlershme me njëra-tjetrën, pasi nuk mund të ndërrohen në çdo rast. Këtë mangësi shqipja standarde e ka plotësuar me përdorimin e formave të shtjelluara të lidhores (Koleci, 2013: 131). Duke e parë më thellë këtë çështje, kujtojmë se kjo, në të vërtetë, është një prirje e vënë re edhe për gjuhë të tjera të Ballkanit. Sh. Demiraj (2012: 5) ka thënë se mënjanimi i paskajores në gjuhën shqipe, ashtu si në gjuhët ballkanike, është kryer pikërisht nëpërmjet zëvendësimit të saj me forma vetore të mënyrës lidhore të prira nga një pjesëz. Gjithashtu, pavarësisht se mbetet e paqartë rruga e formimit të saj, prania e saj e hershme, qoftë edhe vetëm në dialektin verior, dëshmon qartë se përdorimi i paskajores nuk ka qenë i pazakonshëm ndër stërgjyshërit e shqiptarëve edhe në një kohë kur në gjuhët e tjera ballkanike kishte nisur procesi i zëvendësimit të kësaj forme të pashtjelluar nga format vetore të lidhores (po aty: 6). Ai thotë se ka shumë të ngjarë që një zëvendësim i tillë i paskajores nga format vetore të lidhores në krye të herës të jetë vërtetuar në ato raste kur paskajorja i referohej një kryefjale të ndryshme nga ajo e foljes drejtuese, por me kalimin e kohës, mënjanimi i paskajores nëpërmjet përdorimit të formave të lidhores do të ketë ardhur duke u përgjithësuar.

Pra, duke ndjekur pohimin e autorit, mendohet se kjo ka ndodhur në ato raste kur vlera predikative e kësaj forme të pashtjelluar ka qenë më e qartë se në rastet e tjera, pra ka qenë e lidhur me pavarësinë e njësisë predikative.

Ajo që është në interes të trajtimit që do të bëhet në këtë syth, është të citohet mendimi i Demirajt se: "...mënjanimi i paskajores, nëpërmjet zëvendësimit të saj nga format e zgjedhueshme të mënyrës lidhore nën ndikimin e një gjuhe

ndërtime të ndryshme të shqipes shih faqet në vazhdim nga Turano dhe Koleci.

tjetër, mund të përftohej vetëm atëherë kur gjuha e ndikuar të kishte zhvilluar përdorimin e dendur të lidhore si sinonime të paskajores në sa më shumë funksione sintaksore të përbashkëta. E kjo parakupton njëkohësisht që folësit e gjuhës së ndikuar të kenë pësuar një ndryshim të madh në mënyrën e të shprehurit të mendimeve të tyre" (Po aty, f. 8, theksimi ynë, edhe më poshtë). Gjithashtu duhet shënuar edhe pohimi i Demirajt se arsyeja e këtij zëvendësimi është në thelb një prirje e vjetër e gjuhëve të Ballkanit për një qartësim sa më të madh të kuptimit gojor, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe përdorimin redondant të mjeteve gjuhësore. Përdorimi i formave vetore të lidhore në vend të formës së pashtjelluar të paskajores, që nuk e dallon vetën e atij që kryen (apo të atyre që kryejnë) veprimin e shprehur nga kjo formë foljore do të ketë qenë një nga pasojat e kësaj prirjeje ( f. 11).

Këto pohime të autorit na drejtojnë te mendimi i psikolinguistëve, sipas të cilit mund të kuptohet se çdo formë e të shprehurit gjuhësor, është projektuar fillimisht në nivelin mendor, gjë që na jep shkas të shohim lidhjet e këtyre përbërësve në nivelin strukturor e kuptimor, nga njëra anë ndërtimet me paskajore dhe nga ana tjetër ato me lidhore për të parë dallimet mes tyre. Pra, çfarë ndryshimesh pasqyrojnë në nivelin e strukturës dhe të të shprehurit zëvendësimi i paskajores me lidhoren.

Për këtë qëllim do të paraqiten disa pasazhe tekstore të përzgjedhura me format e pashtjelluara nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, është vënë dorë duke i zëvendësuar shumicën e këtyre formave – sidomos të paskajores gege *me + pjesore* – me lidhoren, me qëllim që të shihet nëse ky zëvendësim sjell edhe ndryshime skematike e kuptimore. Për të realizuar këtë janë përzgjedhur shembuj nga autorët e traditës deri në kohët e sotme (ndër të cilët ka edhe gramatikanë): Çabej, Camaj, Fishta, Pllumi, Migjeni, Rrota, Xhuvani.

Po të vëmë përballë këto dy lloj ndërtimesh, nga njëra anë me paskajore dhe nga ana tjetër me lidhore, si më sipër, vihet re se në pamje të parë frazat e përfuara janë gramatikore dhe funksionet e tyre sintaksore përkojnë gjithashtu.

a. ...më kupton se çka dua me thanë (M. Camaj, vepra 1... f. 114)

a1. ...më kupton se çka dua të them...

b. Në këto kater vjet shemtimin na kemi pasë rasë me pà e me ndi shùm të kqija e të liga... (Gj. Fishta, Përndritje)

b1. ...kemi pasur rast të shikojmë e të dëgjomë shumë të këqija e të liga...

c. Prandej sod kà ardhë dita per të gjitha komet e fiset me u shque e mos me ndëjë mytë n'ujë.. (Gj. Fishta, Përndritje, f. 95)

c1. Prandaj sot ka ardhur dita për të gjitha kombet e fiset të ushqehen e mos të rrinë mbytur në ujë.



Mirëpo nga pikëpamja strukturore ky zëvendësim sjell ndryshime të mëdha që do të shihen më tej dhe që rrjedhimisht çojnë edhe te dallime kuptimore të mundshme.

E nisim duke bërë paraqitjen skematike të dy ndërtimeve sipas modelit të përshkruar në sythin paraardhës, *sistemit forcë-shtjellim*, por duke paraqitur vetëm pozicionet e mbushura me material fonetik:

...kupton se çka dua kupton se çka (M. Camaj, vepra me thanë? dua të them? 1... f. 114)

Nga njëra anë është trajta origjinale e autorit me paskajore,

ndërsa në anën tjetër zëvendësimi i mundshëm me lidhore.



Nga paraqitjet e mësipërme që ndihmojnë të shihen lidhjet mes përbërësve dhe hierarkia e tyre, vihet re se qoftë sintagma foljore e pashtjelluar [*me thanë*] e qoftë sintagma komplementuese [*(që) të them*] janë fjali të nënrenditura që shërbejnë si argumente për folje drejtuese *dua*. Në rastin e frazës argumentore të realizuar me paskajore si komplement i foljes së fjalisë drejtuese del një sintagmë foljore e pashtjelluar, ndërsa në rastin e lidhore ajo është një sintagmë komplementuese, pasi lidhëza, edhe pse nuk është e shprehur, mund të vendoset lehtësisht:

...kupton se çka dua [*sk që të them...*]

Lidhja kuptimore është më e fortë në rastin e parë të foljes së pashtjelluar, sesa në rastin e dytë të lidhore e cila është më e pavarur. Si "njësi matëse" për këtë dallim kuptimor ndihmon edhe largësia apo afërsia midis dy sintagmave me koka leksikore me njëra-tjetrën, pra më të afërtat që qëndrojnë në lidhjen midis fjalisë drejtuese dhe asaj të nënrenditur. Dy kokat leksikore në dy strukturat e mësipërme janë foljet, pra folja *dua* dhe folja *them*. Të gjitha të tjerat janë koka funksionale dhe nuk kanë kuptim leksikor të mëvetësishëm. Largësia nga njëra kokë leksikore te tjetra në ndërtimin me

folje të pashtjelluar është më e vogël sesa në rastin me lidhore. Kjo e fundit ka disa koka funksionale si Forcë<sup>0</sup> (ose K<sup>0</sup> po t'i referohemi modelit të analizës së përdorur për sintagmat komplementuese, pra lidhëza "që" edhe pse nuk është e realizuar fonetikisht), Mën<sup>0</sup>, Ept<sup>0</sup>. Pra, është e dukshme se lidhja më e ngushtë kuptimore është në rastin e parë dhe kjo na nxjerr pikërisht te fjalët e Sh. Demirajt të cituara më sipër. Kjo lidhje kuptimore më e ngushtë sjell edhe ndryshime të qarta në shprehësinë e të dyja ndërtimeve.

E njëjta analizë mund të bëhet edhe për shembujt e tjerë të nxjerrë më poshtë me të njëjtin rezultat.

*...derdhen të gjitha ênët e ujit pse për ndryshej Smrt-i (Vdekja) mundet me i pi.* (E. Çabej, Diana dhe Zana, f.37) / *Shpesh herë nuk âsht punë e lehtë me dallue fazat e këtij influksi.* (J. Rrota, Gjuha...f. 35) *Poendë (bilé) në verín e Shqipnis probatini ka detyrë me marrë gjakun e probatinit të vet.* (E. Çabej, Diana...52) / *...nuk paska qenë e vërtetë se ajo s'paska ditë me fluturue.* (M. Camaj, vepra 1... f. 115) / *...Ahmet Zogu po ishte aj pllumi i butë, neper të cillin atà me ndreqë punët e interesat e veta, kur pàn se aj po kishte kënë një iriq e se nuk po ndigjote me u bâ masha e tjeterkujë, fullen me thànë, se Ahmet Zogu dote me ia dhânë koncesjonin e vojtgurit Anglis;...* (Gj. Fishta, Përndritje, f. 119)

## 5. Përfundime

Analiza dhe krahasimi i këtyre dy lloj ndërtimesh, sipas modelit gjenerativ, ndihmon të kuptohet dhe dëshmon se zëvendësimi i formës së pashtjelluar paskajore me formën e shtjelluar lidhore nuk është një zëvendësim formal i pandjeshëm, por ai shoqërohet me një ndryshim në strukturën e brendshme të frazës, në gjenerimin e përbërësve në mendjen e folësit të shqipes, si dhe rrjedhimisht ndryshime në shprehësinë e atij ndërtimi që formohet.

## 6. Referenca

1. ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë:, 2002.
2. Bokshi, B. Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik). ASHAK, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Libri 14*, Besim Bokshi, Prishtinë, 1998.
3. Çeliku, M. Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe. Tiranë: Shblu, 2016.
4. Demiraj, S. "Ç'dëshmon mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike?", në *Studime filologjike*. 2012; (5-13): 1-2.
5. Demiraj, Sh. Gramatika historike e gjuhës shqipe. Prishtinë 1988.
6. Dhima, Th. Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe (përmbledhje artikujsh). Infbotues, Tiranë: 2013.
7. Kananaj, A. Rrethanori në gjuhën shqipe. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë: 2015.
8. Kelmendi, T. *Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën popullore (sipas folklorit)*. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2010.
9. Koleci, F. Frazat relative të shqipes. Tiranë, 2013.
10. Memushaj, R. Gjuhësia gjenerative. Shblu, Tiranë: 2008.
11. Turano, G.; Koleci, F. *Hyrje në gramatikën gjenerative*. Tiranë: SHBLU, 2011.
12. Veselaj, N. Paskajorja çështje e shqipes standarde. Dardania Sacra, Prishtinë, 2000.